



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**V E N D I M**

**Nr. 17, datë 28.02.2014**

**MBI**

**FONDIN E KOMPENSIMIT PËR VITIN 2014**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 45 e vijues të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E :**

Fondi i Kompensimit krijohet bazuar në nenin 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe ka për qëllim pagesën e dëmeve pasurore dhe jo pasurore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur dëmet shkaktohen nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i siguruar sipas ligjit nga ndonjë shoqëri sigurimi, nga një mjet motorik i pidentifikuar apo në rastet e mbylljes apo falimentimit të një shoqërie sigurimi.

Ky Fond krijohet nga:

- Kontributi i përvitshëm i shoqërive të sigurimit;
- Arkëtime nga rimbursimi i shumave nga personat përgjegjës për dëmin;
- Gjobat e vëna pronarit të mjetit të transportit të cilët nuk kanë lidhur kontratat e sigurimit të detyrueshëm;
- Burime të tjera të cilat nuk ndalohen me ligj.

Referuar të dhënave në vite, Fondi i Kompensimit ka pësuar rritje të ndjeshme për shkak të aksidenteve të shumta shkaktuara nga mjetet e pasiguruara apo të pidentifikuara, si dhe nga mosarkëtimi i dëmshpërblimit nga personat përgjegjës apo dhe i gjobave të vëna ndaj pronarëve të mjeteve të pasiguruara.

Referuar “Informacionit mbi treguesit financiarë për periudhën janar - 31 dhjetor 2013”, depozituar në Autoritet, rezulton se deri më 31.12.2013, totali i detyrimeve për pagesat e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit paraqitet si më poshtë:

Sipas statusit të praktikës	Vlera në Lek
<b>Detyrimi për Dëme Pezull Fond Kompensimi deri më 31.12.2013</b>	<b>1,348,126,732.00</b>
Dëme të miratuara por të pa paguara	<b>906,630,325.00</b>
Miratuar nga Komisioni i trajtimit të dëmeve	340,989,200.00
Vendime gjyqësore të formës së prerë	565,641,125.00
Dëme në proces trajtimi	<b>112,054,240.00</b>
Dëme në proces gjyqësor	<b>329,442,167.00</b>

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme, kryesisht vlerat e dëmeve në proces trajtimi dhe dëmeve në proces gjyqësor, paraqiten duke marrë në konsideratë vlerën e rezervës së llogaritur për këto dëme.

Gjithashtu në vlerën totale të detyrimeve për Fond Kompensimi deri më 31.12.2013, nuk përfshihen vlerat e dëmeve të ndodhura por të paraportuara. Në këto kushte vlera totale e cituar më sipër, në fund të periudhës së parashikuar për shlyerjen totale të këtyre detyrimeve pritet të ndryshojë.

Referuar rekomandimeve të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, konkludohet se detyrimet e Byrosë Shqiptare të Sigurimit për dëmet pezull të Fondit të Kompensimit deri me 31 dhjetor 2013, duhet të shlyhen brenda 3 viteve. Byroja do të bëjë axhustimet për përcaktimin e vlerës së detyrimit për vitet në vazhdim deri më datën 10 janar të vitit përkatës.

Sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të anëtarëve nr. 45, datë 27.12.2013, Fondi i Kompensimit për vitin 2014, propozohet në masën 450,000,000 lekë, i ndarë përkatësisht:

- Fond për shlyerjen e detyrimeve për dëme pezull deri më 31.12.2013, në vlerën 430,000,000 lekë;
- Fond për pagesat e dëmeve për vitin 2014, në vlerën 20,000,000 lekë.

Ndarja e detyrimeve për dëme pezull në vlerën 430,000,000 lekë, sipas propozimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nuk është pranuar nga Bordi i Autoritetit.

Bordi vendosi që ky detyrim të ndahet për çdo shoqëri sigurimi sipas pjesëmarrjes në treg referuar primeve bruto të sigurimit të detyrueshëm, për vlerat e detyrimeve sipas viteve më të hershme të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Duke iu referuar të dhënave të marra nga BSHS, për vlerën e detyrimit prej 430 milion lekë, Autoriteti ka përllogaritur detyrimet për dëmet e papaguara, (të miratuara) referuar periudhës më të hershme, të cilat fillojnë nga viti 2001 dhe arrijnë deri në fillim vitit 2009.

Autoriteti, me qëllim shlyerjen e detyrimeve objekt i Fondit të Kompensimit me afat 3 vjeçar ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me anëtarët e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, të cilët do të bëjnë ndarjen e praktikave, si dhe planin e pagesave.

Për sa më sipër Autoriteti,

**V E N D O S I:**

1. Shlyerja e detyrimeve për pagesat e dëmeve pezull deri më 31 dhjetor 2013, në vlerën 1,348,126,732 lekë, do të bëhet brenda tre viteve si më poshtë:

Viti 2014 – 430.000.000 lekë;

Viti 2015 – 450.000.000 lekë;

Viti 2016 – 468.126.732 lekë.

2. Byroja do të bëjë rillogaritjet për përcaktimin e vlerës së detyrimit për vitet 2015 dhe 2016, deri më datën 10 janar të vitit përkatës.
3. Shfuqizohet.
4. Fondi i Kompensimit për pagesat e dëmeve me ngjarje sigurimi nga data 1 janar 2014 e në vazhdim, krijohet duke filluar minimalisht nga vlera 20 milion lekë. Ky fond do të financohet menjëherë nga shoqëritë e sigurimit në përputhje me parashikimet e nenit 45, pika 2, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009.
5. Byroja të bëjë rakordimet për pagesat dhe detyrimet objekt i Fondit të Kompensimit, sipas pikës 4, të këtij vendimi çdo tre muaj.
6. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Enkeleda SHEHI**

( në % )

Pjesmarrja në treg,TPL +Kufitare, sipas viteve

	2009	2008	2007	2006	2005	2004	2003	2002	2001
<b>Shoqëritë</b>									
INSIG	8.0	7.9	11.9	18.4	12.4	11.3	18.2	24.5	40.5
SIGMA	16.0	17.0	17.7	19.3	22.2	29.0	30.6	29.3	30.4
SIGAL	23.5	22.0	22.5	21.5	22.5	25.0	25.5	27.4	24.9
ATLANTIK	11.9	13.3	13.8	10.7	12.1	17.4	11.8	8.8	3.5
INTERSIG	12.1	11.7	8.8	10.2	12.3	15.3	13.8	10.1	0.7
EUROSIG	8.2	7.4	7.3	4.7	3.6	0.3	-	-	-
INTERALBANIAN	10.6	10.2	8.6	7.1	6.8	0.8	-	-	-
ALBSIG	9.7	10.5	9.5	8.1	8.2	0.9	-	-	-
ANSIG	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>GJITHSEJ</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Detyrimi i Fondit të Kompesimit, sipas viteve për vlerën 430 milion Lekë

	2009	2008	2007	2006	2005	2004	2003	2002	2001
<b>Shoqëritë</b>									
INSIG	1,569,919.9	11,269,496.5	13,454,297.3	11,495,143.0	6,170,337.3	948,337.9	2,627,669.9	4,641,683.9	26,851.5
SIGMA	3,134,031.1	24,246,924.0	20,059,590.0	12,046,734.6	11,027,603.2	2,440,396.8	4,421,092.4	5,556,357.6	20,155.2
SIGAL	4,607,162.1	31,469,532.0	25,521,907.1	13,449,465.7	11,175,556.2	2,105,955.0	3,678,962.9	5,201,494.6	16,508.7
ATLANTIK	2,330,280.5	19,022,235.6	15,682,362.2	6,716,545.7	6,002,112.6	1,463,311.7	1,703,804.5	1,668,045.9	2,320.5
INTERSIG	2,363,253.8	16,653,090.0	9,951,998.9	6,386,962.8	6,109,294.1	1,282,556.8	1,995,469.3	1,909,049.1	464.1
EUROSIG	1,617,326.6	10,571,863.5	8,276,249.2	2,952,075.2	1,808,423.9	28,451.6	-	-	-
INTERALBANIAN	2,084,767.4	14,591,257.9	9,706,074.8	4,461,318.9	3,408,052.7	63,621.0	-	-	-
ALBSIG	1,903,224.6	14,996,265.4	10,726,641.4	5,037,834.2	4,063,730.0	76,497.1	-	-	-
ANSIG	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>GJITHSEJ</b>	<b>19,609,966.0</b>	<b>142,820,665.0</b>	<b>113,379,121.0</b>	<b>62,546,080.0</b>	<b>49,765,110.0</b>	<b>8,409,128.0</b>	<b>14,426,999.0</b>	<b>18,976,631.0</b>	<b>66,300.0</b>

(në lekë)

FINANCIMI I FONDIT TË KOMPESIMIT PËR VITIN 2014 SIPAS VENDIMIT TË BORDIT

	Ndarja e detyrimit për dëme pezull	F.K për dëmet e ndodhura gjatë 2014	Vlera në total e Fondit të Kompesimit 2014
<b>Shoqëritë</b>			
INSIG	52,203,737	1,491,600	53,695,338
SIGMA	82,952,885	1,921,535	84,874,420
SIGAL	97,226,544	4,086,012	101,312,556
ATLANTIK	54,591,019	1,732,802	56,323,821
INTERSIG	46,652,139	2,715,150	49,367,289
EUROSIG	25,254,390	3,099,328	28,353,718
INTERALBANIAN	34,315,093	1,365,249	35,680,341
ALBSIG	36,804,193	1,825,408	38,629,601
ANSIG	-	1,762,916	1,762,916
<b>GJITHSEJ</b>	<b>430,000,000</b>	<b>20,000,000</b>	<b>450,000,000</b>